



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 033

KEC

NDRYSHIMI DHE ZHVILLIMI I ORGANIZATËS

Qëllimet e programit

- Aftësimi i pjesëmarrësve për hartimin e projekteve dhe planeve zhvillimore në bazë të teorive bashkëkohore të ndryshimit e të zhvillimit.
- Studimi dhe përvetësimi i koncepteve të ndryshimit e të zhvillimit të organizatave bashkëkohore.

Përmbajtja

Programi përqendrohet rreth tri shtyllave kryesore:

- a) baza teorike: koncepti i ndryshimit, cikli i ndryshimit, bartësit e ndryshimit
- b) instrumentet për menaxhimin e ndryshimit;
- c) planifikimi praktik i ndryshimeve

Pjesa teorike trajton konceptin e ndryshimit përmes teorisë së kompleksitetit (teoria e kaosit) dhe teorisë evolutive. Nocionet e përvetësuara në një qasje interaktive gjatë sesioneve teorike përpunohen pastaj nëpër filtrin e instrumenteve të ndryshme të nevojshme për menaxhimin e ndryshimit. Për këtë qëllim, ushtrohen qasjet e ndryshme dhe instrumentet si: politkat, planifikimi strategjik, planet zhvillimore të organizatës e të tjera.

Pjesa praktike e programit përqendrohet në zbatimin praktik të nocioneve në fushën e planifikimit të ndryshimit përmes hartimit të Planit Zhvillimor të Organizatës. Në këtë pjesë pjesëmarrësit njihen me për së afërmi edhe me zbatimin e mekanizmave të ndryshëm për monitorimin e vlerësimin e implementimit e planeve të ndryshme (relevanca, efikasiteti, efektiviteti dhe qëndrueshmëria financiare).

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet personelit menaxhues të institucioneve publike dhe sektorit joqeveritar.

Forma e organizimit/ kohëzgjatja

Programi ka 22 orë mësimore të strukturuar në 11 sesione gjatë tri ditëve të punës. Qasja është e kombinuar, aftësuese dhe praktike.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja në 90 % të sesioneve.